

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtaren ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale të pandehurit M.Sh. nga P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.7094/15 të datës 12.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit Fillestar me datën 06.09.2018, në prezencën Prokurorit të Shtetit Ajshe Ferati, të akuzuarit, me datën 07.09.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit M.Sh., i biri i A.1 dhe nënës M., e gjinisë A.2, i lindur me ... në P., me vendbanim në rr. "U." ..., nr.... P., me nr.personal ..., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, ka të kryer Fakultetin e Komunikimit masiv, me profesion ..., shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 24.11.2015, rreth orës 11:00, në P. në rrugën "U.", hyrja ..., kati i ..., nr...., gjatë një kontrole nga ana e policisë në banesën në të cilën jeton është gjetur një qese e vogël plastike e tejdukshme me substancë bimore të llojit të Amfetamines, që përmban përbërje kimike të Fenacetinit dhe Kafeinit, me peshë të përgjithshme prej 5.56 gram, ku i njëjti e ka poseduar pa autorizim-,

-Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4,7,41,46,50,51,73,74 të KPRK-së si dhe nenit 365 dhe 248 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit i shqipton:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Të akuzuarit M.Sh., në shumë prej **500 (pesëqind euro) €**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin me gjobë i pandehuri mund ta paguaj deri në 5 (pesë) këste mujore nga 100 (njëqind)

euro në afat kohor prej 5 (pesë) muaj, e me se largu deri me datën 5 (pesë) të muajit vijues nga data e marrjes se formës se prerë të këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do t'a revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgimi duke iu llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në afat prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej **1/një/ viti** nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale.

Obligohet i akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor do të paguaj shumën prej 25 (njëzet e pesë) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën, PP.II.nr. 7094/15 të datës 12.05.2016, kundër të pandehurit M.Sh. nga P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, me vullnet të plotë dhe të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP.II.nr. 7094/15 të datës 12.05.2016.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurit av.A.B. deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit: i mbrojturi im qysh në stadin e parë të ballafaqimit me gjykatën e pranoj fajësinë, është treguar bashkëpunues me organet e ndjekjes, rrezikshmëria shoqërore e veprës është e ulët po ashtu edhe rrezikshmëria e kryesit është e ulët, ngase i njëjti ushtron funksionin e gazetarit dhe dëmi shoqëror në këtë rast nuk ekziston, duke pasur parasysh edhe cilësit personale të kryesit i cili nuk ka ndërmarr ndonjë veprim të kundërligjshëm në dëmtim të shoqërisë dhe është penduar për kryerjen e kësaj veprë, kërkojm nga gjykata ta marr para syshë propozimin tonë dh të njëjtit ti shqiptoj një dënim me gjobë ose me kusht.

I akuzuari pajtohet me të thënat e avokatit të tij.

Prokurori i Ajshe Ferati, dha mendimin e saj lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dhe shtoi se pranimi është bërë në pajtim me nenin 248 par.1 të KPRK-së, që do të thotë se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, dhe i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe kërkon nga gjykata që me rastin e caktimit të dënimit të merr aktin e pranimin të fajësisë si rrethanë lehtësuese ashtu siç parashihet me nenin 75 par.1 pika 1.3 të KPRK-së.

I akuzuari, ndihet fajtor për këtë veprim, është penduar dhe ka deklaruar po ashtu që nuk do të përsëris asnjëherë një veprim të tillë, dhe i propozon gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të këtë parasysh të gjitha këto rrethana dhe të i shqiptoj një dënim sa me të lehtë.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se me datë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, është penduar për veprën e shkaktuar, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 pika 2.6 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.2217/16 të dt: 07.09.2018

Zyrtare Ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.